



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:291098

Datë: 20.12.2024

Numri i dokumentit: 06633084

PAKR.nr.650/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Mentor Bajraktari, kryetar kolegji, Afërdita Bytyçi dhe Valbona Musliu Selimaj, anëtare, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Fitore Batatina, në çështjen penale të akuzuarit V.Gj nga Gjakova, Rr. “Sadik Pozhegu”, p.nr., për shkak të veprës penale, Posedim i paautorizuar i narkotikeve substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1, lidhur me nenin 275 par. 1 pika 1.8 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, av. Muhamet Ibraj, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.111/23, të datës 27.09.2024, në seancën e kolegjit me datë 11.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin e ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, V.Gj, av. Muhamet Ibra, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.111/23, të datës 27.09.2024, sa i përket vendimit mbi dënim, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarin V.Gj, për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor – Posedim i paautorizuar i narkotikeve substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1, lidhur me nenin 275 par. 1 pika 1.8 të KPRK-së, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, ndërsa dënimin me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind) euro, i'a merr të vërtetuar, të cilin dënim i akuzuari obligohet t'a paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij

aktgjykimi, atëherë dënimi do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 €, të pa paguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burgim.

II. Pjesa tjetër e aktgjykimit mbetet e pa ndryshuar.

A r s y e t i m

Më aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.111/23, të datës 27.09.2024, i akuzuari V.Gj, është shpallur fajtor për vepren penale, Posedim i paautorizuar i narkotikeve substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1, lidhur me nenin 275 par. 1 pika 1.8 të KPRK-së, dhe është gjykuar më denim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, e të cilin dënim është obliguar ta paguaj ne afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga koha kur aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm dhe më denim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj, të cilin dënim do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti shndërrohet në dënim me burg, ku 1 (një) ditë burg, do ti llogaritet 20 (njëzet) euro të gjobës.

I akuzuari është obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, për paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 200 (dyqind) euro, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të paguaj shume prej 50 (pesëdhjetë) euro në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi. Të akuzuarit i është konfiskuar substanca narkotike e llojit marihuanë me peshë neto prej 0.1 gram.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit, V.Gj, av. Muhamet Ibra, për shkak të shkeljeve esnciale të dispozitave të procedurës penale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes se ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin me propozim për Gjykatën e Apelit të Kosovës, që aktgjykimin e ankimuar t'a anuloj si dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, ose t'a ndryshoj aktgjykimin sa i përket vendimit mbi dënimin dhe të akuzuarit t'i shqiptoj dënim më të butë.

Prokuroria e Apelit me parashtresën, PPA/I.nr.589/2024, të datës 08.11.2024, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit V.Gj, av. Muhamet Ibra, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr.111/23, të datës 27.09.2, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit caktoj dhe mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPRK-së, në të cilën nuk morën pjesë i akuzuari e as mbrojtësja e tij si dhe nuk prezantoi as Prokurori i Apelit edhe pse të ftuar në mënyrë të rregullt për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit

Mbrojtësi i të akuzuarit V.Gj, av.Muhamet Ibraj, në ankesë pretendon se gjykata ka bërë vlerësim të gabuar të gjendjës faktike në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, sepse nuk i ka vlerësuar dhe analizuar mjaftueshëm dhe në lidhshmëri logjike dhe faktike me njëra tjetrën provat dhe deklaratat e të pandehurit. Mbrojtja lidhur me deklaratën e dëshmitarit A.B, i cili ka deklaruar se ditën kritike ka qenë në Qendrën Korrektuese në Dubravë, i angazhuar në detyrat zyrtare, më saktësisht në përcjellje e shoqërim të të pandehurit V.Gj, e që ka vrejt se gjatë shëtitjes nga pavijon 3 në paviojin 4, me afrimin tek dritaret e krahut V2, duke përcjellë të pandehurin vërejt se sjellja e tij ndryshojë deri në përfundim të shëtitjes, e që të njëjtin e ka veçuar, ku nën praninë e mbikqyrësit Agron Muriqi, kanë basitisur të pandehurin V.Gj, të cilit nuk i kishin gjetur asgjë, por në fund atij i ra një copë letre nga xhepi, mirëpo i njëjti ka tentuar ta marr atë duke pretenduar se i ka rënë stilolapso nga tavolina e mbikqyrësit. Mbrojtja pretendon se me rastin e dhënies së dëshmisë, dëshmitari ka qenë konfuz dhe i pasigurtë duke mos qenë në gjendje për të përcaktuar qartë se i dyshuari a e ka pasur sasinë e narkotikut. Lidhur me vendimin mbi denim mbrojtja ka thekësuar se edhe sikur të vertetohej gjendja faktike duke pasur parasysht sasinë e narkotikut që është 0.1 gram, konsideron se nuk ka vepër penale, të cilën e vlerëson si vepër të rëndësisë së vogël, duke i propozuar Gjykatës së Apelit si më lartë.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë e as që ka shkelje tjera të dispozitave të procedurës penale, për të cilat, sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo Gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e që në ankesë mbrojtësi vetëm ka cekur si pretendim ankimor pa dhënë asnjë

arysetim se ku qendrojnë shkeljet esnciale sipas tij, megjithatë Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare edhe në këtë aspekt konform nenit 394 par.1 të KPPK-së, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje tjera të cilat detyrimisht do të kushtëzonin prishjen e tij.

Pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe gjetjet e kësaj Gjykate.

Sa i përket pretendimeve ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, nga se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari V.Gj ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, ashtu që më datë 22.07.2023, rreth orës 11:25, në Qendrën Korrektuese në Dubravë, K-Istog, në shëtitoren e pavijonit 03, pa autorizim ka poseduar substancë narkotike te llojit marihuanë.

Gjendja faktike është vërtetuar nga deklaratat e dëshmitarit A.B i cili në deklaratën e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt. 11.09.2024 në mënyrë të detajuar ka përshkruar veprimet e të akuzuarit Vedat dhe atë se si fillimisht, deri sa i akuzuari ka qenë në shëtitje dëshmitari Artan, ka vërejtur tek i akuzuari disa lëvizje të dyshimta, afrimi i tij tek rrjeta e pavijonit 4, ku mund të bëhet komunikimi në mes të dënuarve nga pavijoni 3 në pavijonin 4, afrimi tek dritaret e krahut V2, dhe në momentin që e ka vërejt se është duke u përcjellë nga dëshmitari Artan, i akuzuari i ka ndryshuar sjelljet dhe ka ndryshuar edhe pamjen e fytyrës, ku në përfundim të shëtitjes është bastisë nga ana e dëshmitarit dhe nga xhepi të akuzuarit i ka rënë një copë letër në të cilën është gjetur narkotiku i llojit marihuanë.

Kolegji gjen të pa bazuara pretendimet e mbrojtjesit se dëshmitari ka qenë konfuz dhe i pasigurtë në dhënien e deklaratës se tij, duke mos qenë në gjendje për të përcaktuar qartë se i akuzuari a e ka pasur sasinë e narkotikut. Kolegji vëren se deklaratimet e dëshmitarit në esencë janë të njëjta vetëm se gjatë shqyrtimit gjyqësor është deklaruar në mënyrë me të detajuar.

Kolegji vlerëson se gjykata shkallës së parë me të drejtë nuk i ka fal besimin mbrojtjes se të akuzuarit ngase e njëjta është në kundërshtim me vet deklarinimin e të akuzuarit në raport me mënyrën se si ka ardh në posedim të letrës në xhepin e pantallonave ditën kritike. I akuzuari njëherë deklaroi se e ka pas një letër, e ka marr në tokë, të cilën e ka gjet, më pastaj se i'a ka hedh tezaku i tij me një numër të telefonit të shkruar, e përfundimisht deklaroi se njëherë letër e ka marr në dhomën e tij dhe njëherë i'a ka hedh tani djali i axhës, e që i bie që i ka pas dy letra me një laps

në xhepin e tij e të cilin fakt nuk e ka mohuar se e ka pas edhe letrën në xhep me lapsin të cilin e ka marr në dhomën e tij. Ndersa në deklaratën e dhënë ne Polici me dt. 27.11.2023, ka deklaruar se letrën e ka gjetë në tokë edhe e ka mare e ka shti në xhep duke menduar se është numër telefoni. Në deklaratën e dhënë në Prokurorinë Themelore në Pejë - DKR me dt. 27.12.2023, ka deklaruar se të njëjtën e ka gjetur në tokë, dhe e ka marrë këtë letër në tokë në shëtitore, pasi qe aty punon si pastrues për ti mbledhur mbeturinat, pasi qe paraprakisht e ka kërkuar nga një i dënuar tjetër të cilin e ka tezak që më ja dhënë numrin e telefonit të familjareve që i ka jashtë dhe duke menduar se është numri i telefonit e ka futur ne xhep dhe aty e kanë vërejtur gardianet.

Ne deklaratën e dhënë në shqyrtimin gjyqësor, me dt.11.09.2024, ka deklaruar se një djalë i axhës e ka thirr nga dritarja e pavijonit nr. 3 dhe i ka thënë se këtu e ki numrin e babës që është në Gjermani. I akuzuari e ka marre numrin dhe e ka shkruar numrin në një letër, të cilën letër e ka marr nga dhoma e tij. Pastaj letrën e ka shti në xhep, e po ashtu edhe stilolapsin e ka shti në xhep. Ka deklaruar se djalit të axhës i cili ja ka dhënë letrën me numër të telefonit nuk ja din emrin, mirëpo babai i tij i ka treguar se e ka djalë të axhës, i akuzuari ka deklaruar se tani e ka kuptuar se ai nuk është babai i tij.

Nga e lartecekura kolegji gjen se gjykata shkallës së parë drejt ka vleresuar se deklarimet e të akuzuarit kanë qenë kundërthënës, si për nga fakti se si ka ardhë deri në posedim të asaj letre, ashtu edhe për faktin se një herë ka deklaruar se ja ka dhënë djali i tezes, pastaj djali i axhës, mirëpo nuk ja din emrin djalit të axhës. Andaj, deklaratave të akuzuarit me te drejt gjykata nuk u ka fal besimin, meqenëse i njëjti këtë e ka bërë vetëm me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale, gjersa është po ashtu në kundërshtim edhe me provat tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor e ne detale të përshkruara dhe vlersuara në aktgjykimin e ankimuar. Andaj, Gjykata e Apelit duke u bazuar në të gjitha këto që u thanë më lart, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se në këtë çështje penale nuk ka mbetur pa u vërtetuar asnjë fakt vendimtar.

Pretendimet ankimore lidhur me shkeljen e ligjit penal

Kolegji penal vlerëson se me aktgjykimin e ankimuar nuk është shkelur as ligji penal siç pretendon mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë, për faktin se veprimet e të akuzuarit V.Gji përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale, Posedim i paautorizuar i narkotikeve substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1, e lidhur me nenin 275 par. 1 pika 1.8 të KPRK-së, për të cilën është shpallur fajtor, se për këtë vepër penale i njëjti është penalisht përgjegjës, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të të akuzuarit.

Pretendimet ankimore përkitazi me vendimin për dënim dhe gjetjet e gjykatës

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit, konstaton se pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit për një dënim me të butë janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 të KPRK-së. Rrethanë lehtësuese ndaj të akuzuarit gjykata ka marr sasinë jo të madhe të narkotikut të zënë, ndërsa si rrethanë rënduese ka marr faktin se i akuzuari ka qenë i dënuar edhe me parë dhe atë sipas Aktgjykimit, P.nr. 756/2018 të dt. 17.10.2019 nga Gjykata Themelore e Gjakovës i dënuar për veprën penale, Vjedhje e rëndë nga neni 327 të KPRK-së, i dënuar me dënim me burgim dhe me dënim me gjobë, sipas Aktgjykimit P.nr. 24/2019 të dt. 19.12.2019 nga Gjykata Themelore e Gjakovës i dënuar për veprën penale, Vjedhje e rëndë nga neni 327 të KPRK-së i dënuar me dënim me burgim dhe me dënim me gjobë, sipas Aktgjykimit PKR.nr. 68/2019 të dt. 01.07.2020 nga Gjykata Themelore e Gjakovës i dënuar për veprën penale, Grabitje nga neni 329 të KPRK-së, dhe për veprën penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 të KPRK-së, dhe veprën penale, Vjedhje e rëndë nga neni 327 të KPRK-së, i dënuar me dënim me burgim dhe me dënim me gjobë dhe sipas Aktgjykimit, P.nr. 376/2019 të dt. 22.10.2020 nga Gjykata Themelore e Gjakovës i dënuar për veprën penale, Vjedhje e rëndë nga neni 327 të KPRK-së, i dënuar me dënim me burgim dhe me dënim me gjobë, e për të cilat vepra edhe ka qenë dhe është në vuajtje të dënimit në burgun e Dubravës. Gjykata shkallës së parë duke u gjetur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë, siç është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit, e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmën si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale, konform nenit 38 të KPRK-së.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë, siç është bindur se dënimi me burg për të akuzuarin i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë në rrethanat e çështjes rezulton se është dënim i ashpër, duke mos pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe atë sasinë jo të madhe të narkotikut të zënë, e ku pesha e përgjithshme ishte prej 0.1 gram, rrethanat e tij personale dhe familjare, të cilat rrethana në unitetin tyre tregojnë se edhe

me një dënim më të ulët, mund të arrihet qëllimi ndëshkimor i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Duke pasur parasysh rrethanat e lartcekura kolegji penal i kësaj Gjykate ka ndryshuar vetëm vendimin mbi dënim me burg, dhe të njëjtit i ka shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, ndërsa dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, i'a merr të vërtetuar, duke konsideruar se edhe me një dënim me të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit.

Duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara, dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, rrethanave të kryerjes si dhe do t'i shërbej preventivës gjenerale dhe individuale, se me këtë do të ndikoj që personat e tjerë të mos kryejnë vepra penale, kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmën, do të bëhet rehabilitimi i tij, si dhe dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për të arritur qëllimin e dënimit.

Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 403 të KPPRK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për Krime të Rënda

PAKR.nr.650/2024, datë 11.12.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale

Kryetari i kolegjit

Fitore Batatina

Mentor Bajraktari

Anëtarët e kolegjit:

Afërdita Bytyçi

Valbona Musliu Selimaj